



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 39/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Ferizaj, paraqitur kundër Lëvizjes Vetëvendosja (LVV) dega në Ferizaj, për shkak të mbajtjes së tubimit publik para datës së caktuar për fushatë zgjedhore, për zgjedhjet e jashtëzakonshme lokale në Komunën e Ferizajt në seancën e panelit të mbajtur me 13.04.2012, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET poshtë ankesa si e palejuar.

A R S Y E T I M

PZAP-i ka pranuar një ankesë me datën 11.04.2012 nga subjekti politik PDK, me të cilën pretendohet se LVV ka bërë shkelje të Rregullës Zgjedhore Nr. 13/2009 *Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike* për arsye se ka organizuar dhe mbajtur tubim publik me datë 08.04.2012 në ora 19:00, në shkollën fillore “Dituria”, në fshatin Dardani.

Në mbështetje të pretendimeve parashtresuesi i ankesës ka bashkangjitur si provë 7 (shtatë) fotografi dhe ftesën për tubim publik.

Parashtresuesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore për rastin konkret.

KREU -VII- i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP)

Fushata e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike

Neni 44 i LZP-së, përcakton aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe mënyrat e specifikuar me atë dispozitë.

Në dispozitën e nenit 33 të LZP-së dhe Rregullorja Zgjedhore nr. 11/2009, *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*, me dispozitat e lartë cekura ju ndalohen veprimet e subjekteve politike, mbështetësve të tyre ose kandidatëve të tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

PZAP-i nga shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e palejuar

Siç shihet nga shkresat e lëndës pretendimet e theksuara në ankesë, nuk janë bërë gjatë periudhës së fushatës zgjedhore andaj PZAP-i duke u bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore vlerëson se nuk kemi të bëjmë me veprime të ndaluara, ngase me asnjë dispozitë ligjore të LZP-së, e as me Rregulla Zgjedhore nuk është paraparë ndonjë dispozitë ligjore që ndalon mbajtjen e tubimeve publike para datës së caktuar fushatë zgjedhore.

Në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 39/2012 më datën 13.04.2012.

**Kryesuesi i panelit
Muhamet Rexha**

